

Bashkëjetesa ekonomi-arsim e domosdoshme

Nxjerrja e kuadrove të Universitetit të Prishtinës (UP) në përputhje me kërkesat e ekonomisë së vendit, do të jetë prioriteti i përkrahjes ndërkombëtare dhe përkushtimit vendor për përtidhjen e ardhshme trevjeçare. Për të zbatuar këtë strategji, UP, universitetet ndërkombëtare

partnere dhe Komisioni Evropian, të enjten kanë bërë promovimin e projektit "Kohëzotencia në UP (GUP)", i cili financohet nga KE përmes programit TEMPUS.

Ky projekt, sipas përfaqësuesve të UP-së, KE-së dhe universiteteve partnere, synon përmirësimin e lidhjes ndërmjet

kompetencave (shkathësive) të zhvilluara nga institucioni i arsimit të lartë dhe kërkesat e tregut të punës.

Rektori i Universitetit të Prishtinës (UP), Mujë Rugova, ka thënë se një ndër sfidat më të rëndësishme që përballët shoqëria kosovane është reformimi i UP-së në përputhje me

nevojat e tij, procesin e Bolonjes dhe zhvillimin në arsimin e lartë. Ndërkaq, koordinatori i këtij projekti në UP, prorektori për marrëdhënie ndërkombëtare Naser Mirasori, ka përmendur se pikat kryesore në të cilat mbështetet UP për të arritur ndërkombëtarizimin është integrimi i Kosovës në hapësirën

e Unionit Evropian, harmonizimi i programeve sipas Bolonjes, implementimi i krediteve, pjesëmarrja në konferencën ndërkombëtare, mobiliteti i studentëve dhe staffit akademik, mësimi në distancë... Ai ka thënë se UP tani ka realizuar 145 marrëveshje me universitete ndërkombëtare. **A. KADRIU**

17 shkurt, 27/105/2011